



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.34

26 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Udhëzim i KQZ nr.6, datë 23.3.2009	Për numërtimin e zonave të qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi.....	1869
Udhëzim i KQZ nr.7, datë 23.3.2009	Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe të forcave të ushtrisë në zgjedhjet për Kuvendin 2009.....	1879
Udhëzim i KQZ nr.9, datë 25.3.2009	Për caktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit dhe afatet për publikimin e listave të kandidatëve.....	1883

UDHËZIM
Nr.6, datë 23.03.2009

PËR NUMËRTIMIN E ZONAVE TË QENDRAVE TË VOTIMIT NË MËNYRË UNIKE NË SHKALLË VENDI

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pika 1, dhe nenit 62 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat, që duhet të ndiqen nga kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, për numërtimin e zonave të qendrave të votimit në mënyrë unike në shkallë vendi.

Neni 2
Parime të përgjithshme

1. Sistemi unik i numërimit të zonave të qendrave të votimit (SUN) realizon numërtimin e vazhdueshëm të zonave të qendrave të votimit të ngritura në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me anë të këtij sistemi bëhet i mundur identifikimi i zonës së qendrës së votimit nëpërmjet një numri të papërsëritshëm, në përkatësi të çdo njësie të qeverisjes vendore.

2. Numërtimi i zonës së qendrës së votimit bëhet me anë të një numri katërshifror. Numërtimi fillon nga njësia e qeverisjes vendore në veri të vendit, dhe konkretisht nga zona e QV-së nr.0001 e komunës Gruemirë të qarkut të Shkodrës dhe vazhdon në mënyrë progresive në drejtimin veri-jug të vendit, deri në zonën e QV-së nr.4734 të komunës Xarë të qarkut të Vlorës.

3. Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-ve për çdo njësi të qeverisjes vendore jepen në pasqyrën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

4. Zona e qendrës së votimit duhet të jetë brenda një territori kompakt e të pashkëputur gjeografik dhe numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi nuk mund të jetë më i vogël se 150 dhe më i madh se 1000 zgjedhës, me përjashtim të institucioneve të posaçme, ku qendra e votimit mund të ngrihet edhe kur në të ndodhen, të paktën, 15 zgjedhës.

5. Kufijtë e zonave të qendrave të votimit dhe numërtimi i tyre caktohen nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore duke vepruar sipas këtij udhëzimi.

6. Kufijtë ekzistues të zonës së qendrës së votimit ruhen edhe në zgjedhjet pasardhëse, me përjashtim të rastit kur bëhet i domosdoshëm ndryshimi për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Neni 3
Mënyra e numërtimit të zonave të qendrave të votimit kur ka ndryshime

Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në rast se:

a) në njësinë e qeverisjes vendore krijohet një zonë e re qendre votimi, atëherë numërtimi i kësaj zone të re do të realizohet duke i vendosur një numër pesëshifror. Katër shifrat e para do të jenë të njëjta me katër shifrat e para të numrit të zonës së qendrës së votimit më të afërt, brenda njësisë vendore përkatëse, ndërsa shifra e fundit, e pesta, do të jetë 1 (një). Në rastet kur ky numër me shifër të pestë 1 (një) ekziston, atëherë si shifër e fundit do të caktohet numri pasardhës (duhet pasur parasysh që shifra e fundit mund të jetë nga 1 deri në 9).

b) ngrihet një qendër e re votimi brenda një zone qendre votimi ekzistuese, numri që i jepet kësaj qendre të re votimi do të ketë një numër pesëshifror. Katër shifrat e para do të jenë të njëjta me katër shifrat e para të numrit të zonës së qendrës së votimit në të cilën ngrihet, ndërsa shifra e pestë do të jetë numri 1 (një) ose një numër tjetër më i madh (deri në 9), sipas rastit, me rend rritës.

c) shkrihet një zonë qendre votimi, atëherë numri i kësaj zone qendre votimi hiqet nga

përdorimi, duke mos ndryshuar numrat e zonave të tjera të qendrave të votimit.

Neni 4

Detyrat e përcaktuara në këtë udhëzim për Bashkinë e Tiranës ushtrohen nga kryetarët e njësive bashkiake.

Neni 5

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
1	Shkoder	Malesi e Madhe	GRUEMIRE	0001	0025
2	Shkoder	Malesi e Madhe	KASTRAT	0026	0038
3	Shkoder	Malesi e Madhe	KELMEND	0039	0046
4	Shkoder	Malesi e Madhe	KOPLIK	0047	0049

5	Shkoder	Malesi e Madhe	QENDER MALESI E MADHE	0050	0061
6	Shkoder	Malesi e Madhe	SHKREL	0062	0076
7	Shkoder	Shkoder	POSTRIBE	0077	0090
8	Shkoder	Shkoder	PULT	0091	0096
9	Shkoder	Shkoder	RRETHINAT	0097	0114
10	Shkoder	Shkoder	SHALE	0115	0125
11	Shkoder	Shkoder	SHLLAK	0126	0131
12	Shkoder	Shkoder	SHOSH	0132	0134
13	Shkoder	Shkoder	TEMAL	0135	0144
14	Shkoder	Shkoder	BUSHAT	0145	0164
15	Shkoder	Shkoder	HAJMEL	0165	0171
16	Shkoder	Shkoder	VAU-DEJES	0172	0185
17	Shkoder	Shkoder	VIG-MNELE	0186	0192
18	Shkoder	Shkoder	ANA-MALIT	0193	0214
19	Shkoder	Shkoder	BERDICE	0215	0223
20	Shkoder	Shkoder	DAJC-SHKODER	0224	0234
21	Shkoder	Shkoder	SHKODER	0235	0323
22	Shkoder	Shkoder	VELIPOJE	0324	0334
23	Shkoder	Shkoder	GURI I ZI	0335	0347
24	Shkoder	Puke	BLERIM	0348	0354
25	Shkoder	Puke	FIERZE-PUKE	0355	0365
26	Shkoder	Puke	FUSH-ARREZ	0366	0371
27	Shkoder	Puke	GJEGJAN	0372	0381
28	Shkoder	Puke	IBALLE	0382	0389
29	Shkoder	Puke	PUKE	0390	0396
30	Shkoder	Puke	QAFE-MAL	0397	0405
31	Shkoder	Puke	QELEZ	0406	0418
32	Shkoder	Puke	QERRET	0419	0430
33	Shkoder	Puke	RRAPE	0431	0439
34	Kukes	Tropoje	BAJRAM CURRI	0440	0449
35	Kukes	Tropoje	BUJAN	0450	0456
36	Kukes	Tropoje	BYTYC	0457	0471
37	Kukes	Tropoje	FIERZE-TROPOJE	0472	0479
38	Kukes	Tropoje	LEKBIBAJ	0480	0492
39	Kukes	Tropoje	LLUGAJ	0493	0499
40	Kukes	Tropoje	MARGEGAJ	0500	0509
41	Kukes	Tropoje	TROPOJE FSHAT	0510	0524
42	Kukes	Has	FAJZA	0525	0534
43	Kukes	Has	GJINAJ	0535	0540
44	Kukes	Has	GOLAJ	0541	0556
45	Kukes	Has	KRUME	0557	0567
46	Kukes	Kukes	ARREN	0568	0572
47	Kukes	Kukes	BUSHTRICE	0573	0579
48	Kukes	Kukes	GRYKE-CAJE	0580	0583

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
49	Kukes	Kukes	KALIS	0584	0588
50	Kukes	Kukes	MALZI	0589	0600
51	Kukes	Kukes	SURROJ	0601	0604
52	Kukes	Kukes	TERTHORE	0605	0611

53	Kukes	Kukes	UJMISHT	0612	0618
54	Kukes	Kukes	BICAJ	0619	0629
55	Kukes	Kukes	KOLSH-KUKES	0630	0632
56	Kukes	Kukes	KUKES	0633	0652
57	Kukes	Kukes	SHISHTAVEC	0653	0661
58	Kukes	Kukes	SHTIQEN	0662	0667
59	Kukes	Kukes	TOPOJAN	0668	0672
60	Kukes	Kukes	ZAPOD	0673	0679
61	Lezhe	Lezhe	BALLDREN I RI	0680	0689
62	Lezhe	Lezhe	BLINISHT	0690	0696
63	Lezhe	Lezhe	DAJC-LEZHE	0697	0703
64	Lezhe	Lezhe	KALLMET	0704	0708
65	Lezhe	Lezhe	SHENGJIN	0709	0718
66	Lezhe	Lezhe	KOLSH-LEZHE	0719	0728
67	Lezhe	Lezhe	LEZHE	0729	0742
68	Lezhe	Lezhe	SHENKOLL	0743	0752
69	Lezhe	Lezhe	ZEJMEN	0753	0761
70	Lezhe	Lezhe	UNGREJ	0762	0770
71	Lezhe	Mirdite	FAN	0771	0787
72	Lezhe	Mirdite	KACINAR	0788	0794
73	Lezhe	Mirdite	KTHELLE	0795	0803
74	Lezhe	Mirdite	OROSH	0804	0815
75	Lezhe	Mirdite	RRESHEN	0816	0837
76	Lezhe	Mirdite	SELITE-MIRDITE	0838	0846
77	Lezhe	Kurbini	LAC	0847	0862
78	Lezhe	Kurbini	MILOT	0863	0884
79	Lezhe	Mirdite	RUBIK	0885	0898
80	Lezhe	Kurbini	FUSHE-KUQE	0899	0903
81	Lezhe	Kurbini	MAMURAS	0904	0922
82	Diber	Mat	BAZ	0923	0926
83	Diber	Mat	BURREL	0927	0938
84	Diber	Mat	GURE	0939	0944
85	Diber	Mat	KOMSI	0945	0955
86	Diber	Mat	ULEZ	0956	0961
87	Diber	Mat	XIBER	0962	0967
88	Diber	Bulqize	MARTANESH	0968	0976
89	Diber	Diber	SELISHTE	0977	0982
90	Diber	Mat	DERJAN	0983	0989
91	Diber	Mat	KLOS-MAT	0990	1004
92	Diber	Mat	LIS	1005	1011
93	Diber	Mat	MACUKULL	1012	1017
94	Diber	Mat	RUKAJ	1018	1023
95	Diber	Mat	SUC	1024	1028
96	Diber	Bulqize	BULQIZE	1029	1039

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
97	Diber	Bulqize	FUSHE-BULQIZE	1040	1044
98	Diber	Bulqize	GJORICE	1045	1051
99	Diber	Bulqize	OSTREN	1052	1064
100	Diber	Bulqize	SHUPENZE	1065	1076

101	Diber	Bulqize	TREBISHT	1077	1080
102	Diber	Bulqize	ZERQAN	1081	1093
103	Diber	Diber	LUZNI	1094	1099
104	Diber	Diber	MAQELLARE	1100	1122
105	Diber	Diber	MELAN	1123	1134
106	Diber	Diber	PESHKOPI	1135	1146
107	Diber	Diber	QENDER-TOMIN	1147	1163
108	Diber	Diber	ARRAS	1164	1172
109	Diber	Diber	FUSHE-CIDHEN	1173	1177
110	Diber	Diber	KALA DODES	1178	1185
111	Diber	Diber	KAstriot	1186	1201
112	Diber	Diber	LURE	1202	1211
113	Diber	Diber	MUHUR	1212	1218
114	Diber	Diber	SLLOVE	1219	1228
115	Diber	Diber	ZALL- DARDHE	1229	1237
116	Diber	Diber	ZALL-REC	1238	1246
117	Durres	Kruje	BUBQ	1247	1254
118	Durres	Kruje	CUDHI	1255	1264
119	Durres	Kruje	KRUJE	1265	1281
120	Durres	Kruje	NIKEL	1282	1291
121	Durres	Kruje	FUSHE-KRUJE	1292	1308
122	Durres	Kruje	KODER-THUMANE	1309	1322
123	Durres	Durres	ISHEM	1323	1334
124	Durres	Durres	MAMINAS	1335	1343
125	Durres	Durres	MANEZ	1344	1353
126	Durres	Durres	SUKTH	1354	1368
127	Durres	Durres	RASHBULL	1369	1385
128	Durres	Durres	SHIJAK	1386	1394
129	Durres	Durres	XHAFZOTAJ	1395	1407
130	Durres	Durres	DURRES	1408	1504
131	Durres	Durres	GJEPALAJ	1505	1513
132	Durres	Durres	KATUNDI I RI	1514	1528
133	Tirane	Tirane	KASHAR	1529	1544
134	Tirane	Tirane	PREZE	1545	1549
135	Tirane	Tirane	VORE	1550	1563
136	Tirane	Tirane	KAMEZ	1564	1601
137	Tirane	Tirane	BERZHITE	1602	1613
138	Tirane	Tirane	DAJT	1614	1628
139	Tirane	Tirane	KRRABE	1629	1632
140	Tirane	Tirane	PETRELE	1633	1651
141	Tirane	Tirane	SHENGJERGJ	1652	1664
142	Tirane	Tirane	ZALL-BASTAR	1665	1674
143	Tirane	Tirane	TIRANE1	1675	1707
144	Tirane	Tirane	TIRANE2	1708	1748

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
145	Tirane	Tirane	TIRANE3	1749	1781
146	Tirane	Tirane	TIRANE4	1782	1813
147	Tirane	Tirane	TIRANE5	1814	1856
148	Tirane	Tirane	TIRANE6	1857	1881

149	Tirane	Tirane	TIRANE7	1882	1920
150	Tirane	Tirane	TIRANE8	1921	1946
151	Tirane	Tirane	TIRANE9	1947	1978
152	Tirane	Tirane	TIRANE10	1979	1999
153	Tirane	Tirane	TIRANE11	2000	2033
154	Tirane	Tirane	BERXULLE	2034	2039
155	Tirane	Tirane	PASKUQAN	2040	2051
156	Tirane	Tirane	ZALL-HERR	2052	2062
157	Tirane	Tirane	BALDUSHK	2063	2076
158	Tirane	Tirane	FARKE	2077	2084
159	Tirane	Tirane	NDROQ	2085	2098
160	Tirane	Tirane	PEZE	2099	2109
161	Tirane	Tirane	VAQAR	2110	2121
162	Tirane	Kavaje	GOLEM-KAVAJE	2122	2134
163	Tirane	Kavaje	HELMES	2135	2147
164	Tirane	Kavaje	KRYEVIDH	2148	2157
165	Tirane	Kavaje	SYNEJ	2158	2166
166	Tirane	Kavaje	KAVAJE	2167	2196
167	Tirane	Kavaje	GOSE	2197	2203
168	Tirane	Kavaje	LEKAJ	2204	2214
169	Tirane	Kavaje	LUZ I VOGEL	2215	2223
170	Tirane	Kavaje	RROGOZHINE	2224	2233
171	Tirane	Kavaje	SINABALLAJ	2234	2242
172	Elbasan	Peqin	GJOCAJ	2243	2251
173	Elbasan	Peqin	KARINE	2252	2258
174	Elbasan	Peqin	PAJOVE	2259	2270
175	Elbasan	Peqin	PEQIN	2271	2276
176	Elbasan	Peqin	PERPARIM	2277	2290
177	Elbasan	Peqin	SHEZE	2291	2299
178	Elbasan	Elbasan	ELBASAN	2300	2378
179	Elbasan	Elbasan	BRADASHESH	2379	2397
180	Elbasan	Elbasan	FUNARE	2398	2408
181	Elbasan	Elbasan	GRACEN	2409	2417
182	Elbasan	Elbasan	LAB.FUSHE	2418	2423
183	Elbasan	Elbasan	LAB.MAL	2424	2435
184	Elbasan	Elbasan	PAPER	2436	2450
185	Elbasan	Elbasan	GJERGJAN	2451	2457
186	Elbasan	Elbasan	GJINAR	2458	2468
187	Elbasan	Elbasan	SHIRGJAN	2469	2475
188	Elbasan	Elbasan	SHUSHICE-ELBASAN	2476	2485
189	Elbasan	Elbasan	TREGAN	2486	2497
190	Elbasan	Elbasan	ZAVALIN	2498	2503
191	Elbasan	Elbasan	CERRIK	2504	2519
192	Elbasan	Elbasan	GOSTIME	2520	2535

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
193	Elbasan	Elbasan	KLOS-ELBASAN	2536	2543
194	Elbasan	Elbasan	MOLLAS-ELBASAN	2544	2550
195	Elbasan	Elbasan	BELSH	2551	2563
196	Elbasan	Elbasan	FIERZE-ELBASAN	2564	2568
197	Elbasan	Elbasan	GREKAN	2569	2573
198	Elbasan	Elbasan	KAJAN	2574	2583

199	Elbasan	Elbasan	RRASE	2584	2587
200	Elbasan	Elbasan	SHALES	2588	2594
201	Elbasan	Gramsh	GRAMSH	2595	2607
202	Elbasan	Gramsh	KODOVJAT	2608	2619
203	Elbasan	Gramsh	KUKUR	2620	2629
204	Elbasan	Gramsh	KUSHOVE	2630	2637
205	Elbasan	Gramsh	LENIE	2638	2643
206	Elbasan	Gramsh	PISHAJ	2644	2663
207	Elbasan	Gramsh	POROCAN	2664	2668
208	Elbasan	Gramsh	SKENDERBEGAS	2669	2681
209	Elbasan	Gramsh	SULT	2682	2690
210	Elbasan	Gramsh	TUNJE	2691	2703
211	Elbasan	Librazhd	LIBRAZHD	2704	2710
212	Elbasan	Librazhd	LUNIK	2711	2718
213	Elbasan	Librazhd	ORENJE	2719	2729
214	Elbasan	Librazhd	POLIS	2730	2736
215	Elbasan	Librazhd	QENDER-LIBRAZHD	2737	2753
216	Elbasan	Librazhd	STEBLEVE	2754	2760
217	Elbasan	Librazhd	HOTOLISHT	2761	2769
218	Elbasan	Librazhd	PRRENJAS	2770	2775
219	Elbasan	Librazhd	QUKES	2776	2787
220	Elbasan	Librazhd	RAJCE	2788	2796
221	Elbasan	Librazhd	STRAVAJ	2797	2802
222	Fier	Lushnje	BALLAGAT	2803	2810
223	Fier	Lushnje	DUSHK	2811	2822
224	Fier	Lushnje	GOLEM-LUSHNJE	2823	2829
225	Fier	Lushnje	HYSGJOKAJ	2830	2834
226	Fier	Lushnje	KARBUNARE	2835	2844
227	Fier	Lushnje	TERBUF	2845	2855
228	Fier	Lushnje	LUSHNJE	2856	2889
229	Fier	Lushnje	ALLKAJ	2890	2897
230	Fier	Lushnje	BUBULLIME	2898	2905
231	Fier	Lushnje	FIER-SHEGAN	2906	2918
232	Fier	Lushnje	KRUTJE	2919	2931
233	Fier	Lushnje	DIVJAKE	2932	2946
234	Fier	Lushnje	GRABIAN	2947	2952
235	Fier	Lushnje	GRADISHE	2953	2963
236	Fier	Lushnje	KOLONJE	2964	2974
237	Fier	Lushnje	REMAS	2975	2982
238	Fier	Fier	FIER	2983	3033
239	Fier	Fier	KUMAN	3034	3038
240	Fier	Fier	KURJAN	3039	3044

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
241	Fier	Fier	ROSKOVEC	3045	3051
242	Fier	Fier	RUZHDIE	3052	3056
243	Fier	Fier	STRUM	3057	3063
244	Fier	Fier	PATOS	3064	3085
245	Fier	Fier	ZHARREZ	3086	3093

246	Fier	Fier	CAKRAN	3094	3112
247	Fier	Fier	PORTEZ	3113	3123
248	Fier	Fier	QENER(CLIRIM)	3124	3135
249	Fier	Mallakaster	HEKAL	3136	3143
250	Fier	Fier	DERMENAS	3144	3155
251	Fier	Fier	FRAKULL	3156	3167
252	Fier	Fier	LEVAN	3168	3184
253	Fier	Fier	LIBOFSHE	3185	3197
254	Fier	Fier	MBROSTAR	3198	3206
255	Fier	Fier	TOPOJE	3207	3215
256	Fier	Mallakaster	ARANITAS	3216	3222
257	Fier	Mallakaster	BALLSH	3223	3230
258	Fier	Mallakaster	FRATAR	3231	3237
259	Fier	Mallakaster	GRESHICE	3238	3239
260	Fier	Mallakaster	KUTE	3240	3244
261	Fier	Mallakaster	NGRACAN	3245	3246
262	Fier	Mallakaster	QENDER-MALLAKASTER	3247	3259
263	Fier	Mallakaster	SELITE-MALLAKASTER	3260	3263
264	Berat	Berat	BERAT	3264	3316
265	Berat	Berat	VELABISHT	3317	3331
266	Berat	Berat	CUKALAT	3332	3337
267	Berat	Berat	KUTALLI	3338	3349
268	Berat	Berat	SINJE	3350	3363
269	Berat	Berat	TERPAN	3364	3377
270	Gjirokaster	Tepelene	BUZ	3378	3390
271	Gjirokaster	Tepelene	KRAHES	3391	3398
272	Gjirokaster	Tepelene	LUFTINJE	3399	3413
273	Berat	Berat	LUMAS	3414	3426
274	Berat	Berat	OTLLAK	3427	3442
275	Berat	Berat	ROSHNIK	3443	3455
276	Berat	Berat	VERTOP	3456	3467
277	Berat	Berat	POSHNJE	3468	3481
278	Berat	Berat	URA VAJGURE	3482	3491
279	Berat	Kucove	KOZARE	3492	3504
280	Berat	Kucove	PERONDI	3505	3514
281	Berat	Kucove	KUCOVE	3515	3531
282	Berat	Skrapar	BOGOVE	3532	3540
283	Berat	Skrapar	CEPAN	3541	3553
284	Berat	Skrapar	COROVODE	3554	3558
285	Berat	Skrapar	GJERBES	3559	3568
286	Berat	Skrapar	LESHNJE	3569	3574
287	Berat	Skrapar	POLICAN	3575	3582
288	Berat	Skrapar	POTOM	3583	3591

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
289	Berat	Skrapar	QENDER-SKRAPAR	3592	3614
290	Berat	Skrapar	VENDRESHE	3615	3622
291	Berat	Skrapar	ZHEPE	3623	3634
292	Korce	Korce	KORCE	3635	3700
293	Korce	Korce	DRENOVE	3701	3711
294	Korce	Korce	LEKAS	3712	3722
295	Korce	Korce	QENDER(BULGAREC)	3723	3737
296	Korce	Korce	VOSKOP	3738	3745
297	Korce	Korce	VOSKOPOJE	3746	3750
298	Korce	Devoll	PROGER	3751	3758
299	Korce	Devoll	LIQENAS	3759	3767
300	Korce	Devoll	POJAN	3768	3786
301	Korce	Devoll	VRESHTAS	3787	3794
302	Korce	Devoll	GORE	3795	3812
303	Korce	Devoll	LIBONIK	3813	3829
304	Korce	Devoll	MALIQ	3830	3839
305	Korce	Devoll	MOGLICE	3840	3856
306	Korce	Devoll	PIRG	3857	3869
307	Korce	Pogradec	BUCIMAS	3870	3884
308	Korce	Pogradec	POGRADEC	3885	3908
309	Korce	Pogradec	CERRAVE	3909	3920
310	Korce	Pogradec	DARDHAS	3921	3929
311	Korce	Pogradec	HUDENISHT	3930	3938
312	Korce	Pogradec	PROPTISHT	3939	3953
313	Korce	Pogradec	TREBINJE	3954	3968
314	Korce	Pogradec	VELCAN	3969	3977
315	Korce	Devoll	BILISHT	3978	3983
316	Korce	Devoll	HOCISHT	3984	3994
317	Korce	Devoll	MIRAS	3995	4011
318	Korce	Devoll	QENDER (BILISHT)	4012	4023
319	Korce	Kolonje	BARMASH	4024	4032
320	Korce	Kolonje	CLIRIM	4033	4043
321	Korce	Kolonje	ERSEKE	4044	4049
322	Korce	Kolonje	LESKOVIK	4050	4052
323	Korce	Kolonje	MOLLAS-KOLONJE	4053	4065
324	Korce	Kolonje	NOVOSELE-KOLONJE	4066	4071
325	Korce	Kolonje	Q.ERSEKE	4072	4088
326	Korce	Kolonje	Q.LESKOVIK	4089	4099
327	Korce	Korce	MOLLAJ	4100	4106
328	Korce	Korce	VITHKUQ	4107	4119
329	Gjirokaster	Permet	BALLABAN	4120	4133
330	Gjirokaster	Permet	CARCOVE	4134	4142
331	Gjirokaster	Permet	DESHNICE	4143	4156
332	Gjirokaster	Permet	FRASHER	4157	4164
333	Gjirokaster	Permet	KELCYRE	4165	4171
334	Gjirokaster	Permet	PERMET	4172	4177
335	Gjirokaster	Permet	PETRAN	4178	4192
336	Gjirokaster	Permet	QENDER(PISKOVE)	4193	4208

Pasqyra 1

Numrat që përdoren për numërtimin e zonave të QV-së për çdo njësi të qeverisjes vendore

Nr	Qarku	Rrethi	Njësia e qeverisjes vendore	Nr. i zonës së QV-së	
				Nga	Deri
337	Gjirokaster	Permet	SUKE	4209	4222
338	Gjirokaster	Gjirokaster	CEPO	4223	4233
339	Gjirokaster	Gjirokaster	GJIROKASTER	4234	4260
340	Gjirokaster	Gjirokaster	LAZARAT	4261	4263
341	Gjirokaster	Gjirokaster	ANTIGONE	4264	4268
342	Gjirokaster	Gjirokaster	DROPULL I POSHTEM	4269	4285
343	Gjirokaster	Gjirokaster	DROPULL I SIPERM	4286	4303
344	Gjirokaster	Gjirokaster	LIBOHOVE	4304	4305
345	Gjirokaster	Gjirokaster	LUNXHERI	4306	4313
346	Gjirokaster	Gjirokaster	ODRIE	4314	4318
347	Gjirokaster	Gjirokaster	PICAR	4319	4324
348	Gjirokaster	Gjirokaster	POGON	4325	4330
349	Gjirokaster	Gjirokaster	QENDER LIBOHOVE	4331	4337
350	Gjirokaster	Gjirokaster	ZAGORIE	4338	4346
351	Gjirokaster	Tepelene	FSHAT MEMALIAJ	4347	4354
352	Gjirokaster	Tepelene	KURVELESH	4355	4359
353	Gjirokaster	Tepelene	LOPES	4360	4364
354	Gjirokaster	Tepelene	MEMALIAJ	4365	4369
355	Gjirokaster	Tepelene	QENDER-TEPELENE	4370	4383
356	Gjirokaster	Tepelene	QESARAT	4384	4390
357	Gjirokaster	Tepelene	TEPELENE	4391	4397
358	Vlore	Vlore	NOVOSELE-VLORE	4398	4413
359	Vlore	Vlore	QENDER-VLORE	4414	4426
360	Vlore	Vlore	VLORE	4427	4510
361	Vlore	Vlore	ORIKUM	4511	4517
362	Vlore	Vlore	ARMEN	4518	4524
363	Vlore	Vlore	SELENICE	4525	4529
364	Vlore	Vlore	SEVASTER	4530	4538
365	Vlore	Vlore	SHUSHICE-VLORE	4539	4547
366	Vlore	Vlore	VLLAHINE	4548	4559
367	Vlore	Sarande	LUKOVE	4560	4569
368	Vlore	Vlore	BRATAJ	4570	4578
369	Vlore	Vlore	HIMARE	4579	4591
370	Vlore	Vlore	HORE VRANISHT	4592	4600
371	Vlore	Vlore	KOTE	4601	4612
372	Vlore	Delvine	DELVINE	4613	4625
373	Vlore	Delvine	FINIQ	4626	4631
374	Vlore	Delvine	MESOPOTAN	4632	4646
375	Vlore	Delvine	VERGO	4647	4654
376	Vlore	Sarande	SARANDE	4655	4679
377	Vlore	Sarande	KSAMIL	4680	4682
378	Vlore	Sarande	ALIKO	4683	4694
379	Vlore	Sarande	DHIVER	4695	4705
380	Vlore	Sarande	KONISPOL	4706	4708
381	Vlore	Sarande	LIVADHJA	4709	4723
382	Vlore	Sarande	MARKAT	4724	4729
383	Vlore	Sarande	XARE	4730	4734

UDHËZIM
Nr.7, datë 23.3.2009

PËR DETYRAT E POLICISË SË SHETITIT DHE TË FORCAVE TË USHTRISË NË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje nenit 21, pika 1, nenit 5, nenit 109, nenit 110, pika 2, nenit 114, pika 2 dhe 3, nenit 115, pika 7, nenit 121, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, dhe germa “ë” e pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë detyrat e Policisë së Shtetit dhe të Forcave të Ushtrisë gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin 2009.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi, me termin “objekte zgjedhore”, në çdo rast, do të kuptohet ndërtesa ku është vendosur qendra e votimit, komisioni zonës së administrimit zgjedhor dhe vendi i numërimit të votave.

Neni 3
Parime të përgjithshme

1. Rendi dhe siguria gjatë periudhës zgjedhore ruhet nga Policia e Shtetit.
2. Ndalohet përdorimi i forcave të ndërhyrjes së shpejtë dhe forcave speciale në ruajtjen e objekteve zgjedhore.
3. Ndalohet përdorimi i forcave të Policisë së Shtetit dhe atyre të ushtrisë në veprime që mund të cenojnë vullnetin e zgjedhësve.
4. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë gjatë periudhës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë ose në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Objekteve. Në rastet e planifikuara, urdhri me shkrim i Ministrit i dërgohet KQZ-së 5 ditë përpara hyrjes në fuqi. Në rastet e veçanta, kopje e urdhrit me shkrim dërgohet menjëherë në KQZ.
5. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.
6. Ndalohet, gjatë gjithë periudhës zgjedhore, kryerja e ushtrimeve ose manovrave ushtarake jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit nga forcat e ushtrisë.
7. Ndalohet përdorimi apo pjesëmarrja e punonjësve ose strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror në ngjarjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet apo në veprime, që mund të ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve.

Neni 4
Komunikimi ndërmjet KQZ-së, forcave të Policisë dhe Ushtrisë

1. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës zgjedhore, dorëzon menjëherë në KQZ kopje të urdhrave për angazhimin e forcave speciale dhe

forcave të ndërhyrjes së shpejtë.

2. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës zgjedhore, dorëzon menjëherë në KQZ kopje të urdhrave për angazhimin e forcave të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra zgjedhore.

3. Në rast se KQZ-ja vlerëson se veprimtaria e forcave të Policisë së Shtetit ose të ushtrisë mund të dëmtojë apo të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente, ajo ka të drejtë të kërkojë informacione. Institucioni përkatës është i detyruar të paraqesë menjëherë informacion për veprimet e kryera dhe marrjen e masave për zbatimin e ligjit.

4. KQZ-ja i dërgon drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, 30 ditë para ditës së zgjedhjeve, listën e plotë të objekteve zgjedhore dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre.

5. Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit është i detyruar t'i paraqesë KQZ-së, 10 ditë para datës së zgjedhjeve, listën e plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve. Ai është i detyruar të informojë menjëherë KQZ-në për çdo ndryshim në listë.

6. Për secilin nga punonjësit e përfshirë në listë, duhet të përcaktohen, me shkrim, të dhënat personale, grada që mban, detyrat funksionale, vendvendosja e punonjësit gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe në ditën e votimit, emri i eprorit të drejtpërdrejtë të tij, lloji i shërbimit të policisë ku bën pjesë, si dhe, në mënyrë të detajuar, rrethi i detyrave të ngarkuara.

7. Për problemet që mund të lindin gjatë periudhës zgjedhore dhe që kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, KZAZ-të i drejtohen drejtorit të policisë së qarkut, ku ndodhet KZAZ-ja dhe njoftojnë menjëherë KQZ-në.

Neni 5

Ruajtja e objekteve zgjedhore

1. Selia e KZAZ-së ruhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit, nga momenti kur në të mbërrijnë materialet e votimit deri në datën e zgjedhjeve. Ruajtja do të bëhet prej orës 20.00 deri në orën 8.00 të ditës së nesërme.

2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, punonjësi i Policisë së Shtetit, nuk e kryen shërbimin e ruajtjes së selisë së KZAZ-së gjatë kohës kur kjo e fundit është në punë.

3. Shërbimi i ruajtjes, sipas pikës 1 të këtij neni, fillon menjëherë me paraqitjen e kërkesës së kryetarit të KZAZ-së. Kërkesa është me shkrim dhe i dërgohet, për çdo rast, punonjësit të policisë dhe shefit të komisarariatit që mbulon njësinë e qeverisjes vendore, ku është vendosur zyra e KZAZ-së. Në çdo rast, kërkesa i bëhet me dije drejtorit të përgjithshëm të policisë së qarkut.

4. Kryetari i KZAZ-së, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së zgjedhjeve, i dërgon një njoftim me shkrim shefit të komisarariatit të njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet zyra e KZAZ-së. Njoftimi përmban vendndodhjen e KZAZ-së dhe orarin e punës.

5. Policia organizon ruajtjen e qendrave të votimit gjatë natës para ditës së votimit, duke filluar nga momenti kur në KQV mbërrijnë materialet zgjedhore deri në momentin kur KQV-ja fillon veprimet paraprake për çeljen e votimit.

6. Policia organizon ruajtjen e ambientit të vendit të numërimit të votave prej orës 18 00 të ditës së zgjedhjeve deri në momentin e nxjerrjes së tabelave të rezultatit nga KZAZ-ja.

7. Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambienteve të vendit të numërimit të votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ-ja.

Neni 6

Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në ambientet e VNV-së

1. Gjatë procesit të numërimit të votave, kur KZAZ-ja konstaton se në ambientin e VNV-së janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në paragrafin e parë të nenit 121 të Kodit Zgjedhor, u kërkon atyre që të largohen. Në rast refuzimi, merr vendim për njoftimin e punonjësit të Policisë së Shtetit dhe mban shënim në librin e protokollit.

2. Kur në vendin e numërimit të votave rrezikohet rendi, KZAZ-ja, me vendim, thërret organet e Policisë së Shtetit.

3. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit i paraqitet me shkrim organeve të

Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.

4. Me marrjen e vendimit, kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZAZ-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.

5. Sapo forcat e policisë paraqiten në vendin e numërimit të votave, KZAZ-ja u dorëzon atyre menjëherë përpara ndërhyrjes kopje të vendimit për thirrjen e policisë për të ndërhyrë, të firmosur dhe vulosur nga ky komision.

6. Me rivendosjen e rendit në vendin e numërimit të votave, KZAZ-ja, me vendim, u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

7. Vendimi i KZAZ-së për ndërhyrje merret sipas modelit 32 V bashkëngjitur këtij udhëzimi.

Neni 7

Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në ambientet e qendrës së votimit

1. Kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, KQV-ja, me vendim, thërret organet e Policisë së Shtetit.

2. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit, i paraqitet me shkrim organeve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe rrethanave.

3. Me marrjen e vendimit, kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KQV-së thërret menjëherë policinë dhe njofton KZAZ-në për incidentin e ndodhur.

4. Sapo forcat e policisë paraqiten në qendrën e votimit, KQV-ja u dorëzon atyre menjëherë përpara ndërhyrjes kopje të vendimit për thirrjen e policisë për të ndërhyrë, të firmosur dhe vulosur nga ky komision.

5. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja, me vendim, u kërkon forcave të Policisë së Shtetit të largohen.

Neni 8

Veshja dhe armatimi i policisë

1. Punonjësit e forcave të Policisë së Shtetit, të ngarkuara me detyra zgjedhore sipas këtij udhëzimi, janë të detyruar të mbajnë uniformën gjatë ushtrimit të detyrës dhe dokumentin e identifikimit sipas modelit të përcaktuar në lidhjen nr.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

2. Punonjësit e forcave të Policisë së Shtetit, të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve, mbajnë vetëm armatim personal brezi (pistoletë).

3. Punonjësit e forcave të policisë janë të detyruar që, përveç armatimit personal të brezit, të mbajnë dhe automatik në rastet kur ngarkohen me ruajtjen e objekteve zgjedhore gjatë natës dhe gjatë shoqërimit të kutive të votimit nga qendra e votimit në vendin e numërimit të votave, me përjashtim të rastit kur janë ngarkuar të ruajnë godinën ku është caktuar vendi i numërimit të votave.

Neni 9

Lëvizjet e policisë

1. Qarkullimi i forcave të policisë, të ngarkuara me detyra zgjedhore, bëhet vetëm me mjete policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre respektivisht nga KQZ-ja, KZAZ-ja ose nga KQV-ja.

2. Mjetet e përdorura prej policisë, me targa civile, duhet të kenë shenja dalluese që tregojnë se ato janë të ngarkuara me detyra në funksion të zgjedhjeve. Targat civile dhe shenjat dalluese bëhen me dije në KQZ jo më vonë se 10 ditë përpara ditës së zgjedhjeve.

Neni 10

Vendqëndrimi i policisë

1. Punonjësit e forcave të policisë, që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve, me përjashtim të atyre që merren me ruajtjen objekteve zgjedhore, në 24 orët para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, qëndrojnë brenda komisariateve ose në vende dislokimi larg qendrave të banuara.

2. Asnjë person i armatosur, duke përfshirë edhe forcat e policisë dhe ushtarakët, nuk lejohet të qëndrojnë apo të hyjnë në ambientet zgjedhore.

3. Përfshihen nga përcaktimi i bërë në pikën 2 të këtij neni, rastet kur prania e forcave të policisë kërkohet përkatësisht nga KZAZ-ja ose nga KQV-ja, si dhe në rastin e prezencës së punonjësve të Policisë së Burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

Neni 11

Shoqërimi i kutive të votimit dhe i materialeve zgjedhore

1. Me mbylljen e votimit, kryetari i KQV-së njofton komisaratin e policisë dhe KZAZ-në, duke i kërkuar të dërgojë në KQV punonjës të policisë i cili është efektiv i përhershëm i Policisë së Shtetit, përjashtuar POLICINË KRIMINALE (Departamentin e Hetimit të Krimeve) që do të shoqërojë kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.

2. Punonjësi i policisë paraqitet në kohën e caktuar nga KQV-ja dhe pret në hyrje të saj, derisa të dalin anëtarët dhe sekretari, së bashku me kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore.

3. Shoqërimi i kutive të votimit dhe i kutisë së materialeve zgjedhore nga KQV-ja në vendin e numërimit të votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.

4. Gjatë shoqërimit, kutia dhe materialet e tjera zgjedhore administrohen vetëm prej kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarëve të KQV-së. Punonjësi i forcave të policisë nuk ka të drejtë, në asnjë rast, që të posedojë apo të ketë kontakt me materialet e mësipërme.

5. Punonjësi i policisë, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kutive të votimit dhe kutisë së materialeve zgjedhore nga qendra e votimit në vendin e numërimit të votave, garanton shoqërimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga të tretët.

6. Punonjësi i policisë i ngarkuar me shoqërimin e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, për çdo parregullsi të konstatuar gjatë procesit të shoqërimit nga KQV-ja në vendin e numërimit të votave, përpilon një raport shërbimi, si dhe informon njëkohësisht eprorin e tij dhe ky i fundit njofton shefin e komisarariatit të policisë dhe KZAZ-në.

7. Pas procesit të dorëzimit të materialeve zgjedhore, punonjësi i policisë firmos procesverbalin e marrjes në dorëzim, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja, merr një kopje të procesverbalit dhe largohet menjëherë nga ndërtesa e KZAZ-së.

Neni 12

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Arben Ristani

UDHËZIM

Nr.9, datë 25.3.2009

PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR DEPOZITIMIN DHE VERIFIKIMIN E DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT DHE AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTAVE TË KANDIDATËVE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 21, pika 1, nenit 23, pika 1, germa “b”, nenit 67, nenit 68, nenit 69, nenit 71, nenit 72 dhe nenit 73 të ligjit nr.10 019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZON:

PJESA I

QËLLIMI DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të rregullojë procedurat për depozitimin, verifikimin dhe miratimin e listave shumemërore të partive politike dhe dokumentacionit të regjistrimit si kandidat për deputet të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe përcaktimin e afateve për publikimin e listave të kandidatëve për zgjedhjet për Kuvendin të datës 28 qershor 2009.

Neni 2

1. Partia politike që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim, jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Partia politike, pjesëtare e një koalicioni, depoziton në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve.

3. Komiteti nismëtar i regjistruar në KQZ, depoziton jo më vonë se 40 ditë para datës së zgjedhjeve, kërkesën për regjistrim dhe dokumentacionin e kandidimit të kandidatit të propozuar nga zgjedhësit.

4. Lista shumemërore e kandidatëve të partive politike që do të depozitohet në KQZ duhet të ketë renditje të përcaktuar dhe duhet nënshkruar nga kryetari i partisë, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

5. Në çdo rast, të paktën 30 % e kandidatëve të listave shumemërore dhe/ose një në tre emrat e parë të listës duhet t'i përkasë secilës gjini.

6. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumemërore në një zonë zgjedhore, nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. Bëjnë përjashtim nga ky rregull kryetarët e partive politike që konkurrojnë veçmas apo si pjesëtarë të një koalicioni.

PJESA II

DOKUMENTET E KANDIDIMIT

Neni 3

1. Listat shumemërore të partive politike, të cilat zotërojnë të paktën një mandat në Kuvend, duhet të shoqërohen në çdo rast me dokumentacionin e miratuar me vendim të KQZ-së, si më poshtë:

a) deklaratën për çdo kandidat të listës ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 72, pika 2 germa “b” dhe “c” të Kodit Zgjedhor (model 03 K);

b) vërtetimin e Kuvendit të Shqipërisë për zotërimin e mandateve në Kuvend të partisë politike.

2. Në çdo rast, deklaratat me elementet e përcaktuara në pikën 1 germa “a” të këtij neni do të plotësohen sipas të dhënave në dokumentin e identifikimit të kandidatit.

Neni 4

Partitë politike, pjesëtare të një koalicioni, depozitojnë së bashku me listat shumemërore të kandidatëve të tyre, dokumentacionin e përcaktuar në nenin 3 të këtij udhëzimi në rast se të gjitha partitë, pjesëtare të koalicionit, zotërojnë bashkërisht në Kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëtare të koalicionit.

Neni 5

Listat shumemërore të partive politike, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend, duhet të shoqërohen, në çdo rast, me dokumentacionin e miratuar me vendim të KQZ-së, si më poshtë:

- a) deklaratën për çdo kandidat të listës, ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 72, pika “b” dhe “c” të Kodit Zgjedhor (model 03 K);
- b) listën e zgjedhësve që mbështesin listat shumemërore të partisë, me emrat e jo më pak se 10 000 zgjedhësve (model 04 K);
- c) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara KQZ-së (model 06 K); ose
- d) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara noterit.

Neni 6

Listat shumemërore të partive politike, pjesëtare të një koalicioni, të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në Kuvend ose zotërojnë bashkërisht më pak mandate se numri i partive pjesëtare të koalicionit, duhet të shoqërohen në çdo rast me dokumentacionin e miratuar me vendim të KQZ-së, si më poshtë:

- a) deklaratën për çdo kandidat të listës, ku të deklarohen të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 72, pika “b” dhe “c” të Kodit Zgjedhor (model 03 K);
- b) listën e zgjedhësve që mbështesin listat shumemërore të partive të koalicionit, me emrat e jo më pak se 15 000 zgjedhësve (model 04 K);

c) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara KQZ (Model 06 K); ose

d) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara noterit.

Neni 7

1. Komiteti nismëtar për regjistrimin e një kandidati për deputet të propozuar nga zgjedhësit duhet të regjistrohet në KQZ jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Propozimi nga komiteti nismëtar për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit si kandidat për deputet do të shoqërohet në çdo rast nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) kërkesa e komitetit nismëtar për regjistrimin e kandidatit për deputet (model 05 K);
- b) lista me emrat e jo më pak se 1% të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore përkatëse që mbështesin kandidatin (model 04 K);
- c) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara KQZ-së (model 06 K); ose
- d) deklaratat individuale të zgjedhësve për depozitimin e nënshkrimit përpara noterit;
- e) deklarata e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit, se nuk është pjesë e asnjë partie apo koalicioni dhe as nuk mbështet haptazi apo në mënyrë të tërthortë nga ndonjë subjekt apo kandidat tjetër (model 07 K);
- f) kopje të një prej dokumenteve zyrtare të vlefshme të identitetit të kandidatit, si më poshtë:
 - i) kartë identiteti ose
 - ii) pasaportë.

PJESA III DEPOZITIMI I DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT

Neni 8

Depozitimi i nënshkrimit të zgjedhësve para KQZ-së do të bëhet sipas modelit të miratuar me vendim të KQZ-së.

Për pranimin e depozitimit të nënshkrimeve në KQZ, për çdo rast autorizohen me vendim nëpunës të KQZ-së.

Procedura e depozitimit të nënshkrimeve zhvillohet në ambientet e KQZ-së.

Listat mbështetëse për koalicionet, partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit duhet të paraqiten të printuara dhe në format elektronik.

Neni 9

Dokumentacioni i kandidimit depozitohet në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumenteve, protokoll në KQZ.

PJESA IV VERIFIKIMI I DOKUMENTACIONIT TË KANDIDIMIT

Neni 10

1. Për verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, KQZ-ja krijon me vendim një grup pune. Grupi i punës përbëhet nga:

- një përfaqësues i Drejtorisë Juridike;
- një përfaqësues i Drejtorisë së Komisioneve Zgjedhore;
- një përfaqësues i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

2. Pas protokollimit në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumenteve, protokoll, dokumentacioni merret në shqyrtim menjëherë nga grupi i punës.

Neni 11

1. Pas verifikimit të dokumentacionit të kandidimit sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor dhe të këtij udhëzimi, grupi i punës përgatit një relacion në lidhje me dokumentacionin e paraqitur.

2. Nëse dokumentacioni vlerësohet i plotë dhe në përputhje me përcaktimet e Kodit Zgjedhor, së bashku me relacionin e grupit të punës i kalon për miratim KQZ-së.

Neni 12

Nëse grupi i punës vëren parregullsi, jo më vonë se 3 ditë nga paraqitja e dokumentacionit, i paraqet një relacion KQZ-së, në të cilin parashtrohen parregullsitë e konstatuara. KQZ-ja shprehet me vendim për kthimin për korrigjim të parregullsive të konstatuara në dokumentacionin e paraqitur. Vendimi i kthimit për korrigjim të dokumentacionit merret jo më vonë se 35 ditë nga data e zgjedhjeve.

Neni 13

Verifikimi, nëse shtetasi i listës mbështetëse të partive politike është i regjistruar në listën paraprake të zgjedhësve dhe në rastin e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit, të jetë zgjedhës i zonës zgjedhore përkatëse, bëhet nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit. Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit pajiset me programin aplikativ të përshtatshëm për identifikimin e zgjedhësve, në bazën e të dhënave elektronike të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Neni 14

Për verifikimin nëse një zgjedhës ka mbështetur më shumë se një koalicion, parti politike apo kandidat të propozuar nga zgjedhësit, DTI-ja kontrollon nëpërmjet programit/eve kompjuterik listat mbështetëse të paraqitura në format elektronik nga subjektet zgjedhore.

Neni 15

Nëse gjatë verifikimit rezulton se një zgjedhës figuron në dy a më shumë lista mbështetëse të subjekteve zgjedhore të ndryshme, grupi i punës paraqet relacionin në KQZ, e cila, me vendim, ua kthen ato subjekteve zgjedhore të bëjnë korrigjimet e duhura sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 73 të Kodit Zgjedhor.

Neni 16

Dokumentacioni i korrigjuar nga subjektet zgjedhore depozitohet në zyrën e regjistrimit të akteve dhe dokumenteve, protokoll në KQZ, jo më vonë se 32 ditë para datës së zgjedhjeve.

PJESA V AFATET PËR PUBLIKIMIN E LISTËS SË KANDIDATËVE

Neni 17

Pas mbarimit të afatit të ankimimeve në Kolegjin Zgjedhor, por jo më vonë se data 13 qershor 2009, KQZ-ja publikon listën e plotë të kandidatëve në tri gazetatat me tirazh më të madh në shkallë vendi, në mediat elektronike, si dhe në faqen zyrtare të saj në internet. Një kopje të listës për çdo zonë zgjedhore i dërgohet prefektit, këshillit të qarkut dhe KZAZ-ve, të cilat e publikojnë atë në mediat vendore dhe e shpallin në vende publike në zonën e tyre.

Neni 18

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Arben Ristani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 26.3.2009
Doli nga shtypi më 26.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë